



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

## **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit:

**Programi Fillor**

*Niveli i studimeve:*

Bachelor

*Numri i kredive:*

240 ECTS

*Akredituar për periudhën:*

1 Tetor 2024 - 30 Shtator 2029

# 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit Fillor është t'u ofrojë studentëve njohuri, aftësi dhe vlera të nevojshme për të kryer profesionin e mësuesit në arsimin fillor. Programi synon të pajisë studentët me njohuritë e përmbajtjes kurrikulare për nivelin e dhënë dhe me njohuritë dhe aftësitë pedagogjike të nevojshme për të dhënë një mësimdhënie efektive. Programi synon t'umundësojë studentëve që të jenë të përgatitur për të përballuar detyrat dhe pritjet e profesionit të mësuesit, duke përfshirë të kuptuarit e mjedisit të përshtatshëm të të mësuarit, planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës, si dhe kuptimin e faktorëve që ndikojnë në të mësuarit e suksesshëm. Programi synon të përgatisë mësues të rinj që të jenë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe profesionit të mësuesit duke ndjekur trende bashkëkohore në mësimdhënien cilësore duke përfshirë integrimin e teknologjisë dhe përshtatjen e mësimdhënies së tyre me specifikat e studentëve.

Misioni i programit Fillor është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve, të cilët janë të gatshëm të kontribuojnë në zhvillimin e shkollës dhe profesionit të mësuesit.

## 2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Në fund të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë fenomenet dhe konceptet teorike për të mësuarit dhe edukimin e nxënësve si dhe të përshkruajnë ndërlidhjen e tyre me proceset mësimore në klasë;
- Planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë procesin mësimor sipas filozofisë së kurrikulës arsimore dhe fushave të ndryshme kurrikulare brenda saj si dhe integrimin ndërlëndor;
- Planifikojnë dhe zbatojnë aktivitete mësimore që reflektojnë mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe që reagon ndaj kompleksitetit të mësimdhënies dhe realiteteve në sistemin shkollor;
- Integrojnë inovacionet arsimore në praktikën e tyre profesionale duke marrë parasysh nevojat e nxënësve dhe zhvillimet në shkencën e edukimit;
- Shfrytëzojnë teknologjinë digjitale në funksion të avancimit të të nxënit;
- Krijojnë aktivitete dhe procese mësimore duke iu përshtatur stileve të ndryshme të të mësuarit, përfshirë aftësinë për të ofruar mësim të diferencuar;
- Demonstrojnë aftësi të të menduarit bazuar në të menduarit shkencor, përfshirë aftësinë e tyre për t'u përfshirë në punë kërkimore për të përmirësuar praktikën e tyre të mësimdhënies;
- Demonstrojnë se kuptojnë proceset e të mësuarit dhe zhvillimin e fëmijut si dhe i trajtojnë nxënësit si qenie njerëzore të afta të përjetojnë mjedisin e tyre nga një dimension holistik;
- Demonstrojnë një kuptim të sistemit të vlerave që sistemi arsimor parauniversitar i Kosovës synon të arrijë dhe janë në gjendje t'i lidhin ato me procesin e mësimdhënies;
- Planifikojnë mësimin dhe krijojnë situata për qasje gjithëpërfshirëse në procesin e zbatimit të planit mësimor, duke i dhënë mundësi të barabarta secilit;
- Planifikojnë dhe zbatojnë vlerësimin e bazuar në kompetenca duke përfshirë lloje të ndryshme të vlerësimit formativ dhe përmbledhës.
- Krijojnë mjedisin arsimor për të siguruar ambient miqësor dhe konstruktiv të të mësuarit duke përfshirë ndërveprimin midis fëmijëve si dhe ndërveprime midis fëmijëve dhe të rriturve.
- Krijojnë situata mësimi dhe aktivitete që mundësojnë zhvillimin e potencialit maksimal të nxënësve dhe aftësinë e tyre për shqyrtim të informacionit dhe interpretim e përpunim të tyre për qëllime të cakruara;
- Demonstrojnë të kuptuar të funksionimit të sistemit të arsimit dhe ndërlidhja e punës së mësimdhënësve me funksionimin e shkollës, politikave arsimore, realitetit shkollor dhe pika tjera referuese të politikave e indikatorëve për mësimdhënien cilësore në nivel vendi dhe më gjërë.

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Fillor

VITI I PARË - PROGRAMI EDUKIMI FILLOR					
SEMESTRI I					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	HYRJE NË EDUKIM	2	2	6
2	O	GJUHË SHQIPE I	3	2	6
3	O	MATEMATIKË I	3	2	6
4	O	GJUHË ANGLEZE I	3	2	6
5	O	PROCESET PSIKIKE DHEPERSONALITETI	2	2	6
			15	5	30
SEMESTRI II					
1	O	TEORI E MËSIMIT	3	1	5
2	O	EDUKATË MUZIKORE MEMETODOLOGJI	3	2	6
3	O	GJUHË SHQIPE II	3	2	6
4	O	PSIKOLOGJI ZHVILLIMORE	2	2	5
5	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE	3	0	4
6	Z	SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK	2	0	4
7	Z	KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	0	4
8	Z	GJUHË ANGEZE II	2	0	4
9	Z	ETIKA DHE INTEGRITETI PROFESIONAL	2	0	4
			17	1	30
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					

VITI I DYTË - PROGRAMI FILLOR					
SEMESTRI III					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	SHKENCAT SHOQËRORE MEMETODOLOGJI	3	1	5
2	O	GJUHË SHQIPE III	3	1	5
3	O	TIK NË EDUKIMIN FILLOR	2	2	5
4	O	METODIKA E EDUKIMIT FIZIK	2	2	5
5	O	MATEMATIKË II	3	2	6
6	Z	DRAMATIZIMI DHE KUKULLAT	2	0	4
7	Z	STRATEGJITË DHE METODAT ESHKRIM LEXIMIT	2	0	4
8	Z	INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE	2	0	4
9	Z	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
			15	5	30
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					
SEMESTRI IV					
1	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3	2	6

2	O	HISTORI KOMBËTARE	3	0	5
3	O	SHKENCAT E NATYRËS MEMETODOLOGJI I	3	2	6
4	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE II	3	0	5
5	Z	MËSIMI JASHTËKURRIKULAR	2	0	4
6	Z	EDUKIMI PËR QYTETARIDEMOKRATIKE	2	0	4
7	Z	STATISTIKË ELEMENTARE	2	0	4
8	Z	EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETËSOR	2	0	4
			16	2	30
*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					

VITI I TRETË - PROGRAMI FILLOR					
SEMESTRI V					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	EDUKIMI GJITHPËRFSHIRËS	3	2	6
2	O	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	2	2	5
3	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE III	3	0	5
4	O	ARTET FIGURATIVE MEMETODOLOGJI	3	2	6
5	Z	DIGJITALIZI NË ARSIM	2	0	4
6	Z	STRATEGJITË BASHKËKOHORE TËMËSIMDHËNIES	2	0	4
7	Z	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	2	0	4
8	Z	HISTORI E ARSIMIT KOMBËTAR	2	0	4
			14	4	30
*Studenti zgjedh DY kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z)					
SEMESTRI VI					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	2	5
2	O	SHKENCAT E NATYRËS ME METODOLOGJI II	3	2	6
3	O	MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS I	3	2	6
4	O	METODOLOGJI E GJUHËS DHELETËRSISË SHQIPE	3	1	5
5	Z	QYTETËRIMI SHQIPTAR	2	0	4
6	Z	MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR DHE PIA	2	0	4
7	Z	ETNOLOGJI DHE LETËRSIPOPULLORE	2	0	4
8	Z	MËSIMI NË NATYRË	2	0	4
			16	2	30
*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					
Viti i katërt - Programi Fillor					
Semestri VII					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	VLERËSIMI NË ARSIM	2	2	5
2	O	LETËRSI KOMBËTARE	3	0	5
3	O	MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS II	3	2	6
4	O	SHKATHTËSITË PËR JETË	3	2	6
5	Z	VËSHITËRËSITË NË TË NXËNË	2	0	4

6	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM	2	0	4
7	Z	EDUKIMI PËR STEAM	2	0	4
8	Z	LOJËRAT MATEMATIKORE	2	0	4
			14	4	30
*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					
<b>Semestri VIII</b>					
<b>Kursi</b>		<b>Emri i kursit</b>	<b>L</b>	<b>U</b>	<b>ECTS</b>
1	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	3	2	6
2	O	PRAKTIKË PEDAGOGJIKE IV	3	0	14
3	O	TEMA E DIPLOMËS	6	1	10

## 1. PËRSHKRIMET E KURSEVE

### Përshkrimi për secilin kurs

#### HYRJE NË EDUKIM

Kursi ka për qëllim të ofrojë për studentët një perspektivë bazike rreth çështjeve me rëndësi për profesionin dhe sistemin e arsimit në Kosovë me fokus të vecantë. Kursi fillon me definimin e nocioneve kryesore në fushën e edukimit. Tutje, kursi trajton temat si: vlerat që avokon sistemi i arsimit në Kosovë, dimensionin filozofik dhe politik i funksionimit të sistemit të arsimit në Kosovë nga perspektiva e legjislacionit; parimet themelore të funksionimit të shkollës në Kosovë duke përfshirë edhe orientimet, parimet dhe politikat kurrikulare; si dhe standardet e profesionit të mësimdhënësit në Kosovë.

#### GJUHË SHQIPE I

Përmes këtij kursi studentët do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre paraprake përkitazi me: shqipen si gjuhë indoevropiane, prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentimin e saj, dialektet dhe rrugën e zhvillimit të saj. Ata do të njihen teorikisht dhe praktikisht edhe me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimin, drejtshkrimin, dallimin e tingujve nga morfemat, klasifikimin e tingujve, nyjëtimin e tyre; për prozodinë: rrokjen, theksin, intonacionin, dukuritë fonetike etj. Po ashtu do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e leksikologjisë: sinonimet, antonimet; për ligjërimet - stilet dhe regjistrat e gjuhës etj.

#### MATEMATIKA I

Në këtë kurs shqyrtohen koncepte themelore matematike, siç janë: gjykimet, bashkësitë, relacionet binare, pasqyrimet, numrat, përqindjet, proporcionet etj. Kursi ka një fokusim të veçantë në zgjidhjen e problemeve me fjalë, që përndryshe është qendra e çdo kurrikule bashkëkohore matematike në të gjitha nivelet e shkollimit. Ky fokusim krijon hapësirë për zhvillimin e të menduarit kritik dhe për praktikimin e strategjive dhe teknikave bashkëkohore për zgjidhjen e problemeve të integruara të matematikës me fushat tjera si dhe me jetën reale dhe profesionin e ardhshëm të studentëve. Shqyrtimi i elementeve themelore nga statistika dhe probabiliteti është gjithashtu temë studimi në këtë kurs.

#### GJUHË ANGLEZE I

Gjuhë angleze I është kurs semestral obligativ, i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, të cilat kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga përditshmëria, nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i

përmirësojnë të gjitha shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit do të përfshijnë një llojllojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut, të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performancës gjuhësore si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.

#### PROCESET PSIQIKE DHE PERSONALITETI

Lënda "Proceset psikike dhe personaliteti" synon të jap njohuri të përgjithshme mbi proceset, veçoritë dhe karakteristikat psikike për të ndërlidhur ato me zhvillimin e personalitetit të njeriut. Kursi shtjellon në detaje proceset psikike të adresuara në tri kategorizime si ato kognitive, emocionale dhe sjellore për të vazhduar me ndikimet kryesore në zhvillimin e personalitetit. Trajtohen teoritë e ndryshme për zhvillimin e personalitetit dhe adresohen hulumtimet kryesore në fushën e personalitetit. Thëks i vecantë i kushtohet tipareve themelore të personalitetit të njeriut, përfshirë këtu krijimit të vlerave dhe besimeve. Në këtë aspekt shtjellohen dinamikat në mes të ndikimeve të trashëgimisë dhe edukimit.

#### TEORI E MËSIMIT

Kursi ofron njohuri për kornizën e teorisë së mësimin dhe çështjet e praktikës mësimore nga perspektiva didaktike. Gjatë kursit do të shtjellohen temat si: nocionet themelore didaktike, teoritë e të nxënës, faktorët e mësimin, planprogrami mësimor dhe teoria e kurrikulës, metodat, format dhe mjetet mësimore, struktura dhe etapat e procesit mësimor, organizimi i mësimin dhe artikulumin i orës mësimore, detyrat e shtëpisë. Studentët gjithashtu do të njihen me qëllimin, funksionin dhe parimet e kurrikulës bërthamë për arsimin fillor, fushat, kompetencat dhe dizajnimin i rezultateve të të nxënës, integrimi ndërlëndor dhe konceptet bazë për planifikimin e mësimin.

#### PSIKOLOGJI ZHVILLIMORE

Kursi adreson zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës nga lindja deri në adoleshencë dhe proceset e vazhdueshme të funksionimit psikologjik të fëmijës. Kursi shtjellon nocionet e zhvillimit të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Studentët mësojnë për teoritë dhe studimet sistematike të zhvillimit të fëmijës, fazat e zhvillimit nga mosha paranatale deri në përfundim të fëmijërisë, karakteristikat e vecanta të secilës fazë dhe rreziqet që shoqërohen me atë fazë. Temat përfshijnë zhvillimin fizik-motorik, kognitiv dhe socio-emocional gjatë gjithë fëmijërisë, me theks në momentet kryesore të zhvillimit, faktorët ndikues dhe dallimet individuale. Studentët aftësohen për aplikim të parimeve të



psikologjisë së zhvillimit në skenarë të botës reale, të tilla si mjediset arsimore, praktikat e prindërimit dhe ndërhyrjet që synojnë promovimin e zhvillimit pozitiv. Kursi shtjellon edhe çështjet etike në kërkimin dhe praktikën zhvillimore, duke theksuar rëndësinë e marrjes parasysh të mirëqenies dhe të drejtave të individëve në faza të ndryshme të zhvillimit.

## GJUHË SHQIPE II

Gjatë ligjëratave në kursin e gjuhës amtare (shqipe) II, e në saje edhe të të nxënit (nga shkollimi paraprak dhe nga kursi I i gjuhës i mbajtur në semestrin paraprak), studentët do kenë mundësi t'i zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e morfologjisë, si për: objektin e studimit të morfologjisë, strukturën morfologjike të fjalës, elementet e fjalëformimit: morfemat fjalëformu-ese dhe trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emrin, (nyjat), mbiemrin, numërorin, përemrin, foljen; pjesët e pandry-shueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrat etj.

## EDUKATË MUZIKORE ME METODOLOGJI

Kursi është i ndarë në dy pjesë dhe ofron njohuri dhe shkathtësi muzikore të cilat do të realizohen në mënyrë teorike dhe praktike. Në pjesën e parë të këtij kursi studentët do të përvetësojnë konceptet themelore muzikore dhe do të njihen me mjetet shprehëse muzikore të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikes. Në pjesën e dytë të kursit studentët do të përvetësojnë metoda, teknika dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies së muzikës në veprimtari të ndryshme si: krijim, interpretim, dëgjim, cmuarje dhe vlerësimin për nivelin fillor (nga kl. 1-rë deri tek kl. 5-stë).

## PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I

Lënda "Praktika pedagogjike I" ofron një qasje bazë në çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e praktikave mësimore në kuadër të arsimit fillor. Kursi mundëson ndërlidhjen e njohurive teorike me praktikën pedagogjike. Studentët njihen dhe zbatojnë kodin e mirësjelljes dhe përgjegjësitë e tyre në ambientin shkollor. Kursi parashikon përgatitjen e studentëve për njohjen, identifikimin dhe zbatimin e praktikave efektive të mësimdhënies në klasë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve. Për më shumë, ata përgatiten për të vëzhguar, dokumentuar dhe raportuar përvojën e tyre praktike, por edhe për të reflektuar mbi situata të caktuara në klasë. Kursi është ideuar t'u mundësojë studentëve të njohin elementet bazë të ambientit të shkollës, organizimin e mësimin, të kuptuarit e elementeve të komunikimit efektiv, si dhe rëndësinë e krijimit të një mjedisi të shëndoshë socio-emocional dhe bashkëpunues në klasë. Studentët prezantojnë dhe vlerësojnë reflektimet e tyre pas përfundimit të praktikës, duke përmbyllur eksperiencën mësimore.

## SHKATHTËSITË E STUDIMIT AKADEMIK

Lënda Shkathtësitë e studimit akademik është në funksion të përmirësimit të aftësisë për të mësuar si dhe për të ruajtur njohuritë, ashtu që me zhvillim të shkathtësive të mira të studimit të rritet besimi, kompetenca dhe vetëvlerësimi. Në kurs përfshin çështje të shkathtësive si: strategjitë për mësimnxënie të suksesshme, mjetet që ndihmojnë kujtesën, teknika të të mësuarit, këshilla për fusha të ndryshme/shprehitë e mira të studimit, teknikat e të lexuarit për të kuptuarit e saktë të tekstit, strategjitë për të dëgjuarit aktiv dhe mbajtjen e shënimeve, strategjitë për hulumtim dhe evidentim të burimeve, strategjitë për planifikimin dhe menaxhimin efektiv të kohës, strategjitë për menaxhim të ankthit dhe stresit para provimit. Studentët do të zbulojnë se mund të mësohen shkathtësitë e mësimit, që ka mundësi të përmirësojnë edhe mësimnxënien e tyre si dhe kur do të jenë mësimdhënës në shërbim do të jenë mbështetës e orientues në procesin e të nxënimit të nxënësve.

## KOMUNIKIMI NË ARSIM

Kursi "Shkathtësitë e Komunikimit me Fëmijët" shtjellon më tutje njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e lëndëve psikologjike, për t'i aftësuar studentët ti zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët. Kursi shtjellon teorinë e Vigotskit dhe të Piazhësë mbi format e komunikimit dhe punës me fëmijët, dhe të kuptuarit e llojeve të ndryshme të lojës së fëmijëve. Çfarë na thonë hulumtimet më të reja për format e komunikimit me fëmijë, për ndikimin e të rriturve tek fëmijët, për ndikimet e mjeteve të informimit dhe komunikimit masiv. Si ndikojnë eksperiencat e komunikimit gjatë fazave të ndryshme zhvillimore në krijimin e vetrespektit, vetbesimit, vetimazhit dhe në zhvillimin/formësimin e personalitetit në përgjithësi. Përgjatë gjithë kursit do të theksohen teorinë, hulumtimet dhe përvojat në ndërveprimin me fëmijët, dhe mënyrat si mund të përkrahim zhvillimin e fëmijëve.

## GJUHË ANGLEZE II

Gjuhë angleze II është kurs zgjedhor, i cili si vazhdimësi e kursit Gjuhë angleze I, i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, nëpërmjet të cilave studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht do t'i avancojnë katër shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit, por kësaj rradhe duke përdorur struktura më të ndërlikuara gjuhësore si dhe leksik më të pasur. Kursi konsiston nga një sërë temash, duke filluar nga përditshmëria e deri te zhvillimet më të fundit në teknologji, si çështje me shumë interes për të rinjtë, të cilat do t'u ndihmojnë studentëve që shkathtësitë e fituara t'i shfrytëzojnë jo vetëm në situata të ndryshme komunikative, por edhe në funksion të zhvillimit të tyre profesional, nëpërmjet leximit të literaturës profesionale nga fusha e edukimit që përmban

fjalor i cili përkon me nivelin e njohurive të fituara gjatë kursit.

#### ETIKA DHE INTEGRITETI PROFESIONAL

Kursi trajton konceptet themelore etike, mënyrat e mësimit të etikës, gjenezën e vlerave etike, dokumente për sjelljen etike të akterëve shkollor e në theks të veçantë të mësimitdhënësit, parimet etike, kodin e sjelljes së mësimitdhënësit. Studentët do të njihen me modele të të mësuarit të "Përgjegjësisë", "Ndershmërisë", "Integritetit", "Respektit", me modele të inkurajimit të "Sjelljes sociale" brenda dhe jashtë klasës, modele për të mësuarit të "Kujdesit", dhe vetëdijësimin e tyre për shmangien e formave të ndryshme korruptive. Si dhe me kuptimin për "Betimin e mësuesit".

#### SHKENCAT SHOQËRORE ME METODOLOGJI

Ky kurs integron studimin e shkencave shoqërore me metodologjitë efektive të mësimitdhënies, të dizajnuara për të pajisur mësimitdhënësit aspirantë me një të kuptuar të thellë të disiplinave të shkencave shoqërore dhe metodave e mjeteve pedagogjike të nevojshme për mësimitdhënie të suksesshme. Shkencat shoqërore për studentët ofrojnë njohuri që janë thelbësore për të siguruar aftësi sociale, kulturore dhe analitike që janë të kërkuara për t'u përshtatur gjithnjë e më shumë me një botë të ndërvarur dhe për të kuptuar politikat dhe realitetet ekonomike.

#### GJUHË SHQIPE III

Në këtë kurs studentet do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprake, përkritazi me organizimin e tekstit: objektin e studimit të sintaksës, klasifikimin e togfjalëshave, klasifikimin dhe llojet e fjalive për nga struktura e tyre, modaliteti etj., gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë: Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën klasifikimit dhe të llojeve të fjalisë së përbërë (fjalitë e bashkërenditura dhe fjalitë e nënrenditura).

#### MATEMATIKA II

Kursi përmban një rishikim të koncepteve elementare algjebrike, shprehjet algjebrike, ekuacionet lineare me dy ndryshore, grafikun e ekuacioneve lineare, sistemet e ekuacioneve lineare me dy ndryshore dhe zbatimin e tyre. Po ashtu, në këtë kurs do të shqyrtohen kuptimet themelore nga gjeometria elementare si: trekëndëshi, perimetri dhe sipërfaqja trekëndëshe, katërkëndëshi dhe llojet e katërkëndëshave, rrethi, transformimet izometrike, madhësitë dhe matja e tyre, perimetri dhe syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe, trupat gjeometrik, syprina dhe vëllimi i tyre.

#### TIK NË EDUKIMIN FILLOR

Ky kurs fokusohet në karakteristikat themelore të sistemit kompjuterik,

shfrytëzimin e sistemeve të ndryshme operative për pajisje të ndryshme, shfrytëzimin e programeve aplikative lidhur me zbatimin e tyre në aktivitete arsimore, shfrytëzimin e burimeve të internetit për komunikim dhe informacion, modelimin e aktiviteteve për fëmijë duke shfrytëzuar softverë të ndryshëm arsimor si dhe zbatimin e tyre për lojëra edukative në programin edukimi fillor.

#### METODIKA E EDUKIMI FIZIK

Metodika e Edukimit Fizik u kushton një vend të rëndësishëm parimeve të të mësuarit. Diskutimin mbi to ajo e bën përkrahë diskutimit të parimeve, formave dhe metodave të përgjithshme të edukimit fizik. Parimet e të mësuarit janë ato kërkesa të përgjithshme themelore me karakter shkencor, pedagogjik e psikologjik, mbi bazën e të cilave ndërtohet procesi mësimor, brendia, format, metodat dhe teknikat e të mësuarit në përputhje me qëllimet e metodikes së edukimit fizik. Me përmbajtje të edukimit fizik kuptojmë një sistem të caktuar dijesh me karakter njohës, psikomotor e emocional, të cilat parashikohen për t'u përvetësuar nga nxënësit në mënyrë të përshkallëzuar e sistematike nga klasa në klasë dhe nga cikli në cikël në përputhje me vecoritë e tyre anatomo – fiziologjike e psikologjike. Ky sistem dijesh planifikohet duke u mbështetur në qëllimet, objektivat dhe mjetet e edukimit fizik. Karakteristikë themelore e përmbajtjes është skicimi në 3 nivele konceptuale: Kapitull, linja, nënlinja me spektër të gjerë dhe çështje mësimore. Kështu psh njohuritë për kulturën fizike përfshijnë: ndërtimin e aparatit lëvizor mbështetës dhe funksionet e tij lëvizore, sjelljen lëvizore të nxënësit (njeriut), higjienën e ushtrimeve fizike metodiken e të ushtruarit të pavarur dhe lëvizjen olimpike. Të gjitha këto tema zberthehen në çështje mësimore, ku sintetizohen shkurt kontekstet e dijeve që do të përvetësojnë nxënësit gjatë periudhës së shkollimit.

#### DRAMATIZIMI DHE KUKULLAT

Ky kurs synon të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuritë lidhur me konceptet kryesore të tekstit të dramatizuar përrallave apo tregimeve të cilat inskenohen në teatër. Kursi vë theksin më shumë te komunikimi me nxënësit dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim. Loja e aktorit me kukullën.

#### STRATEGJITË DHE METODAT E SHKRIM-LEXIMIT

Me anë të këtij kursi synohet të argumentohet se strategjitë, metodat dhe format e mësimit të leximit dhe shkrimit jo vetëm që janë të aplikueshme, por edhe të dobishme në procesin e mësimit dhe nxënies së shkrim-leximit. Kursi jep njohuri të detajuara për strategjitë e mësimit të gjuhës (sipas Oxfordit) dhe ndarjen e tyre, si dhe për metodat dhe format e mësimit të shkrim-leximit.

#### INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE

Kursi është i dizajnuar për t'i përgatitur studentët që të interpretojnë në instrumente muzikore me tastierë (piano, sintisajzer) dhe instrumentet fëmijërore (sidomos ato nga grupi i instrumenteve të Orffit). Përmes këtij kursi studentët do të aftësohen të interpretojnë këngë të ndryshme me specifika për nivelin fillor (klasa 1-5). Këngët do t'i demonstrojnë në mënyrë praktike duke aplikuar teknika funksionale të interpretimit.

#### EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Lënda "Edukimi në fëmijërinë e hershme" ka për qëllim të përqendrohet në shtjellimin e temave që lidhen me edukimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme, si moshë shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve. Përmbajtja e shkurtër e kësaj lënde përfshin teoritikisht dhe praktikisht temat kryesore të çështjeve që lidhen me edukimin e fëmijëve, pastaj punës që bëhet në institucione parashkollore, lojën, si veprimtari kryesore e fëmijëve të kësaj moshe, dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve parashkollore dhe shkollës fillore, në veçanti. Në përgjithësi, lënda Edukimi në fëmijërinë e hershme, përpjeket të sigurojë një kuptim të thellë dhe praktik të rëndësishme që ka puna me fëmijë në fëmijërinë e hershme. Studentët përgatiten për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie të suksesshme me prindërit dhe profesionistët tjerë, duke promovuar një mjedis të pasur dhe mbështetës veçanërisht për fëmijët nga lindja deri në moshën 6 vjeçare, po edhe në klasën e parë.

#### SHKENCAT NATYRORE ME METODOLOGJI I

Kursi ofron elaborimin e koncepteve shkencore me qëllim të ndërtimit të njohurive konceptuale dhe procedurale për fenomenet shkencore që ndodhin në botën përreth nesh. Përdorimi mirë-planifikuar i temave të integruara me qasje kërkuese do të ketë rol të rëndësishëm gjatë procesit të mësimdhënies. Në këtë mënyrë do të modifikohen, ndërtohen dhe zhvillohen një gamë e gjerë konceptesh dhe idesh shkencore. Kursi planifikon përfshirjen e studentëve në vëzhgim, pyetje, diskutim, parashikim, analiza, eksplorim, kërkim dhe eksperimentim me qëllim të zhvillimit të shkathtësive krijuese. Zhvillimi dhe ndërtimi i njohurive dhe shkathësive që ata fitojnë mund të aplikohet në dizajnimin e aktiviteteve me qasje kërkuese si mësimdhënës të ardhshëm. Gjithashtu do të bëhet promovimi i shkencës dhe kontributit të saj në shoqëri.

#### LETËRSI PËR FËMIJË

Letërsi për fëmijë, si lëndë në nivelin universitar ka për qëllim t'i njohë studentët e programit fillor me letërsinë për fëmijë si fushë specifike e letërsisë në përgjithësi, si dhe me autorë e vepra që bëjnë vlerat kulminante të saj. Në këtë mënyrë studentët do të njihen me llojet letrare për fëmijë dhe do të aftësohen për punë kërkimore shkencore, duke u aftësuar për bartjen e këtyre njohurive të fëmijët, por

edhe te mësimdhënësit e ardhshëm, duke aplikuar metodologji, strategji, parime, kritere, tekinke e forma të punës që lidhen me punën ne institucionet parashkollore, para së gjithash, por edhe me mësimdhënien e letrësisë në shkollë.

## PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II

Praktika Pedagogjike II ofron mundësi të zhvillimit të shkathtësive për zbatim të suksesshëm të parimeve e strategjive të mësimdhënies, meqë rast studentët do të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e mësimdhënësve brenda kulturës së shkollës dhe klasës. Në Praktikën pedagogjike II, studentët do të zhvillojnë aftësitë për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies, si dhe do të shohin funksionimin e shkollës si organizatë. Lënda Praktika pedagogjike II, organizohet në 15 javë ligjërata, në kuadër të tyre nga 3 ditë për 7 javë praktikë e drejtpërdrejtë në shkollë, duke mundësuar kështu lidhjen e teorisë së mësuar me praktikën. Gjatë 7 javëve në praktikën pedagogjike II, studentët do të dokumentojnë në portofol përvojën e tyre, të sjellë nëpërmjet detyrave/ projekteve/ në procesin e vëzhgimit dhe mësimdhënies në shkollën përkatëse, sipas udhëzimeve dhe detyrave të dhëna nga profesori i lëndës.

## HISTORI KOMBËTARE

Në këtë lëndë trajtohen tema të cilat kanë të bëjnë me të kaluarën historike të popullit tonë, që nga krijimi i etnosit ilirë e deri në kohën bashkëkohore. Lënda fillon nga civilizimet më të hershme të Ilirëve, për t'u lidhur pastaj me civilizimin mesjetar arbëror, si dhe ndikimet e këtij civilizimi në rrjedhat e përgjithshme evropiane me theks te veçantë në periudhën e humanizmit dhe renesancës evropiane, Rilindjes kombëtare, përudhen e shpalljes së pavarësisë, për të përfunduar me shtetin e Kosovës.

## MËSIMI JASHTËKURRIKULAR

Mësimi jashtëkurrikular, ka për qëllim përgatitjen e studentëve për të planifikuar, organizuar dhe realizuar në praktikë aktivitete të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve dhe fushave mësimore formale, por që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave sic janë:

- Vizitat në muze, në parqe, në vende në natyrë dhe në vende historike, në institucione, në galeri, në teatër etj.;
- Festimet për data të veçanta, festa, nga tradita;
- Pjesëmarrja në vendimmarrje në shkollë dhe në format e tjera të demokracisë së shkollës;
- Pjesëmarrja në grupe mësimore, në aktivitete të lira dhe në shoqata Diskutimet me mysafirët (d.m.th., me udhëheqësit e bashkësisë, me prindërit, me përfaqësuesit e bizneseve lokale, me politikanë, me njerëz të medias);

- Puna me projekte që fokusohen në tema dhe në çështje specifike të karakterit shumëdimensional që përkojnë me moshën e nxënësve;
- Ekspozitat (d.m.th. artet e bukura, fotografia);
- Shërbimet për bashkësinë (d.m.th. ndihma për personat në nevojë, mbrojtja e mjedisit, forcimi i lidhjeve midis brezave);
- Lojërat, koret, rivistat e shkollës;
- Puna vullnetare etj.

#### EDUKIMI PËR QYTETARI DEMOKRATIKE

Edukimi për qytetari demokratike synon përgatjen e studentëve mbi edukimin, ngritjen e vetëdijes, informimin për të mbrojtur të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve në shoqëri, për të vlerësuar diversitetin dhe për të luajtur një rol aktiv në jetën demokratike, për mbrojtjen dhe përparimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës. Në këtë lëndë përfshihet edhe “Edukimi për të drejtat e njeriut” që nënkupton edukimin, trajnimin, ngritjen e vetëdijes, informimin, praktikën dhe veprimtarinë që ato synojnë, përmes pajisjes së studentëve me njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe sjellje që i aftësojnë dhe i fuqizojnë ata për të dhënë ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

#### STATISTIKA ELEMENTARE

Në kursin Statistika elementare shqyrtohen konceptet themelore të statistikës: Pupollacioni, mostra, mesatarja, mediana, moda, histogramet, masat e vendndodhjes qëndrore, varianca, devijimi standard, pozita relative e të dhënave, rregulla empirike, konceptet bazike mbi probabilitetin, shpërndarjet e ndryshoreve të rastit, lakorja normale, korelacioni, shpresa matematikore, intervalet e besueshmërisë dhe testimi i hipotezave.

#### EDUKIMI FIZIK DHE SHËNDETËSOR

Ky modul shqyrton shëndetin dhe përcaktuesit e shëndetit, aspektet rregullative vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme për shëndet, burimet dhe mundësitë për edukim shëndetësor, përgjegjësitë e edukatorëve shëndetësor në mësimin për shëndetin dhe promovimin e shëndetit. Perspektivat kulturore në shëndet dhe sëmundje. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe multidisiplinar në promovim dhe parandalim të sëmundjeve dhe planifikim të aktiviteteve. Mjediset e shëndetshme. Shkollat promovuese të shëndetit. Shkathtësitë komunikuese të aplikuara në edukimin shëndetësor. Vetitë e edukatorit të mirë. Metodën dhe mjetet edukativo shëndetësore. Ndikimi i mediave dhe materialeve audio vizuale.

## EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit gjithëpërfshirës. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me nocionet themelore të edukimit gjithëpërfshirës, zhvillimin e legjislacionit botëror dhe vendor në mbështetje të realizimit të kulturës gjithëpërfshirëse, rolin e institucionit shkollor dhe të mësimdhënësit në krijimin e klimës gjithëpërfshirëse, bashkëpunimin me qendrat burimore, mësimdhënësit mbështetës, prindërit, profesionistët dhe komunitetin në funksion të gjithëpërfshirjes, gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, indeksin për gjithëpërfshirje, hartimin dhe implementimin e planit individual të arsimit (PIA), si dhe etikën dhe mbrojtjen e nxënësve e cila është përparësi e proceseve gjithëpërfshirëse.

## PSIKOLOGJI EDUKIMI

Vijuesit në këtë kurs do të marrin informacione për procese, parimet dhe teoritë e ndryshme psikologjike dhe zbatimin e tyre në kontekstin arsimor . Kursi do të përfshijë zbatimin e psikologjisë në studimin e zhvillimit, të nxënësve, mësimdhënies, motivimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me procesin e edukimit. Kursi fillon me një kuptim të përgjithshëm mbi zhvillimin kognitiv, duke u fokusuar në teoritë e Jean Piaget për zhvillimin kognitiv. Në vijim, trajtohen teoritë e zhvillimit personal të Sigmund Freud dhe Erik Erikson, si dhe teoritë e zhvillimit moral të Piaget, Kohlberg dhe Gilligan, të cilat janë thelbësore për të kuptuar ndërveprimet dhe sjelljet në mjedisin arsimor.

## PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III (6JAVË)

Praktika pedagogjike III synon që studentët të zhvillojnë njohuritë, shkathtësit dhe qëndrimet e caktuara për të qenë mësimdhënës në nivelin e shkollës fillore si dhe të zbatojnë strategji të ndryshme të cilat shpiejnë drejt zhvillimit të tyre si mësimdhënës refektues. Kjo pjesë përfshinë edhe zhvillimin e aftësive për të krijuar dhe menaxhuar një ambient kultivues dhe përkrahës të nxënies dhe për të planifikuar dhe mbajtur mësim sipas planprogramit të shkollës si dhe për t'u njohur me funksionimin e shkollës si organizatë. Ky kurs synon të zhvillojë tek studentet të menduarit kritik, zgjedhjen e problemeve, kreativitetin, komunikimin, shkathtësi teknologjike, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të hartuar dhe zbatuar strategji mësimore efektive, për të vlerësuar përparimin e nxënësve dhe për të krijuar një mjedis mbështetës dhe gjithëpërfshirës në klasë. Komponenta e mësimi praktik do të përfshijë edhe kohën e kaluar në ligjërata në aktivitete mësimi, edhe kohën e kaluar në klasa të shkollave.

## ARTET FIGURATIVE ME METODOLOGJI

Në kuadër të kësaj lënde, studentët e programit fillor do të përfitojnë njohuri themelore për artet figurative, konceptet e përgjithshme të cilat janë të organizuara në katër dimensione themelore si: Krijimtaria dhe performanca



artistike, gjuha dhe komunikimi artistic, relacioni art - shoqëri dhe çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik. Studentët do të inkurajohen që të shfrytëzojnë artet jo vetëm si krijimtari kreative dhe për zhvillim të imagjinatës por edhe si metodologji të punës me fëmijë në secilën lëndë të kurrikulës duke integruar këtë fushë me të gjitha fushat e tjera të kurrikulës.

#### DIGJITALIZIMI NË ARSIM

Lënda trajton teknologjinë dhe mediat digjitale si mjete për mësimdhënie dhe mësimin në epokën digjitale. Kursi fokusohet në përdorimin e teknologjisë (platforma digjitale në internet, realitet i shtuar, robotë humanoidë, AI gjeneruese) për të transformuar klasat tradicionale në klasa inovative dhe më dinamike për rritjen e shkrim-leximit digjital, kompetencën digjitale, kreativitetin dhe të menduarit kritik. Më tej studentët do të fitojnë kompetencat digjitale të kornizës CompDigEdu për dizajnimin, krijimin, zbatimin dhe ndarjen e burimeve të mësimin në internet.

#### STRATEGJITË BASHKËKOHORE TË MËSIMDHËNIES

Strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, është një kurs që fokusohet në mënyrë tipike në metodat, qasjet dhe filozofitë inovative dhe efektive të mësimdhënies të përshtatura për mësimdhënësit që punojnë me fëmijët në mjediset e shkollës fillor. Përmbajtja e kursit përfshin koncepte të zhvillimit të mësimdhënies bazuar në stile të ndryshme të të nxënës duke prekur strategji të llojlloshme që përmbushin nevojat e secilit nxënës dhe kështu duke siguruar gjithëpërfshirje, të nxënës aktiv, motivim për të nxënë, zhvillim të shkathtësive të buta dhe të mendimit kritik e kreativ.

#### METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e metodologjisë së leximit letrar. Studentët do të njihen me metodat bazike sesi të interpretohet mirëfilli dhe pa paragjykime një tekst letrar. Në këtë kurs do të trajtohen rëndësia e leximit, kuptimit dhe interpretimit të teksteve letrare në varësi të klasave dhe moshës së fëmijëve. Kursi ofron ide dhe qasje bashkëkohore ndaj problemeve teoriko-letrare dhe lidhjen e tyre me interpretimin dhe identifikimin e këtyre njohurive në tekstet bazë të ciklit fillor.

#### HISTORI E ARSIMIT KOMBËTAR

Kursi përfshinë tema të ndryshme si: Kultura ilire, jeta, besimi dhe simbolet e kultit; kultura mesjetare shqiptare; Historia e shkollës dhe arsimit shqiptarë në periudhën e renesancës. Një vend i rëndësishëm i kushtohet zhvillimit të arsimit dhe kulturës në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, sidomos luftës dhe përpjekjeve të popullit dhe patriotëve shqiptarë për zhvillimin e arsimit kombëtar, për hapjen e

shkollave në gjuhën shqipe. Gjithashtu, në këtë kurs trajtohet zhvillimi i arsimit dhe i kulturës shqiptare gjatë periudhës së pavarësisë, ku trajtohet zhvillimi i arsimit dhe kulturës kombëtare në shtetin e pavarur shqiptar. Tema tjera që përfshihen në këtë kurs paraqesin arsimin dhe kulturën gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, përpjekjet për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës në vitet 1920-1924; arsimin dhe kulturën në periudhën 1925-1939; historinë e zhvillimit të arsimit dhe kulturës që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në fund të viteve 1980; historia e arsimit gjatë viteve të 90-ta e deri më sot në Kosovë.

#### BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimeve në edukim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e të nxëniet, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve. Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxëniet.

#### SHKENCAT E NATYRËS ME METODOLOGJI II

Kursi Shkencat e natyrës me metodologji 2, u dedikohet studentëve që përgatiten për mësimdhënës klasor për t'i pajisur ata me njohuri dhe shkathtësi lidhur me konceptet shkencore jetën e gjallë në përgjithësi, karakteristikat themelore, organizimin dhe funksionimin e saj në të vetmin planet ku ajo dihet se ekziston deri sot duke i kombinuar me shkathtësitë pedagogjike për mësimdhënie të biologjisë në klasë dhe natyrë.

Kursi do të ofroj njohuritë e nevojshme shkencore biologjike lidhur: aspektet citologjike, histologjike, organike, fiziologjike, ekologjike, gjenetike dhe evolutive të qenieve të gjalla, të përcjella edhe me komponentën metodologjike dhe didaktike për mësimdhënie efektive të biologjisë. Kursi do t'i pajis studentët edhe me strategjitë më të mira të mësimdhënies së shkencës biologjike tek fëmijët e nivelit fillor (klasa 1-5) në kuadër të Fushës kurrikulare Shkencat e natyrës-Koncepti Bota e gjallë.

#### MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS I

Kjo lëndë është i dizajnuar për të përgatitur mësimdhënësit e ardhshëm të shkollës fillore për mësimdhënie të matematikës. Gjatë zhvillimit të lëndës, studentët do të zbulojnë se si fëmijët mendojnë dhe mësojnë të arsyetojnë, komunikojnë dhe të zgjidhin probleme duke përdorur strategji të ndryshme. Studentët do të marrin përvojën e duhur për zhvillimin e koncepteve për numrat dhe numërimin, modelet për vend-vlerën e shifrave të numrave natyrorë, zhvillimin e të menduarit për

veprimet themelore dhe numrave natyrorë dhe thyesorë. Poashtu, do të shqyrtohen edhe teoritë e të nxënësve të matematikës, strategjitë e mësimdhënies, mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve, planifikimi, shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit, manipulativeve, teksteve dhe teknologjisë (programeve aplikative) dhe vlerësimi i nxënësve në matematikë.

#### METODOLOGJI E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

Kursi përfshinë pesë përbërës të gjuhës, letërsisë dhe disaktikës së tyre. Në radhë të parë ligjërohen nocionet, konceptet, metodat dhe historia e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe në raport edhe me fushat tjera të dijes: pedagogjinë, artet, psikologjinë, kulturën dhe shkencat e natyrës. Më tej vihet theksi në format didaktike të mësimdhënies dhe përvijës klasike e aspekteve bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës e të letërsisë sot. Një pjesë më vete i kushtohet punës me gramatikën e gjuhës, letërsisë dhe raporteve të saj me kurikulen.

#### QYTETËRIM SHQIPTAR

Ky kurs fokusohet në qytetërimin shqiptar, zhvillimin e tij nëpër etapat historike, ndikimet e jashtme, ndikimet religjioze dhe transformimet e brendshme të qytetërimit shqiptar. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: krijimi i qytetërimit shqiptar, ndikimet e jashtme, qytetërimi ilir, qytetërimi arbëror, qytetërimi shqiptar dhe krishterizmi, qytetërimi shqiptar dhe islamizmi, qytetërimi shqiptar dhe krijimi i shtetit kombëtar shqiptar, qytetërimi shqiptar përball integriteteve ndërkombëtare dhe globalizimit. Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e qytetërimit shqiptar dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies dhe të nxënësve.

#### MËSIMDHËNIA E DIFERENCUAR DHE PIA

Njëra ndër sfidat me rëndësi në mësimdhënien e sotme është aftësia për t'u përgjigjur në mënyrë pozitive dhe proaktive ndaj dallimeve ndërmjet nxënësve, pra ndaj diversitetit në klasë. Prandaj, përmes kësaj lënde do të adresohen çështjet e përmendura duke vënë theksin në mësimdhënien e diferencuar ose adaptive dhe në planin, përkatësisht programin e individualizuar për ata nxënës të cilët janë në rrezik për të dështuar në shkollimin e tyre. Mësimdhënia e diferencuar përcaktohet si një punë mësimore e cila përshtatet mbi bazën e karakteristikave dhe nevojave individuale të nxënësve. Të dhënat tregojnë se nëse zbatohet si duhet, mësimdhënia e diferencuar mund të ketë ndikim në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve.

#### ETNOLOGJI ME LETËRSI POPULLORE

Etnologjia me Letërsi Popullore mëton që studentëve t'u mundësojë:

- Të kuptojnë diversitetin kulturor
- Të kuptojnë mënyrat dhe format e ruajtjes së trashëgimisë kulturore
- Të kuptojnë metodat e krijimit, të shfrytëzimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit kulturor
- Të kuptojnë dhe të jenë pjesë e shkëmbimit dhe e mirëkuptimit kulturor
- Të fitojnë njohuri dhe të zotërojnë mënyrat dhe metodat e politikave informuese dhe të zhvillimit
- Të hynë në botën dhe të jenë pjesë e mjedisit të studimit dhe kërkimit akademik

## MËSIMI NË NATYRË

Kursi ka për qëllim avancimin e rolit të nxënësit përmes zhvillimit të aktiviteteve në mësimore në natyrë me qëllim të nxitjes së kuriozitetit, kreativitetit, vëzhgimit dhe zhvillimit të mendimit kritik tek fëmijët. Studentet duhet të pajisen me njohuri si të bëjnë ndërlidhjen e kurrikulës mësimore me konceptet shkencore përmes eksplorimit, lojës, ekzaminimit, vëzhgimit dhe të mësuarit në natyrë. Në këtë kurs ata do të fitojnë njohuri bashkëkohore mbi organizimin e mësimin në natyrë, infrastrukturën e nevojshme, ndërlidhjen e aktiviteteve të njeriut me natyrën dhe vlerat që merr njeriu nga ajo. Po ashtu do të fitojnë njohuri bazike për eksplorimin e fenomeneve duke argumentuar qasje e cila ndihmon në përmes elementeve praktike në komunikimi, bashkëbisedim, vizatimit, në mënyrën e të shkruarit, si dhe reflektim ndaj koncepteve shkencore. Marrë parasysh edhe njohuritë e studentëve të fituara në kurset paraprake, leksionet do të fokusohen po ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërlidhjen e natyrës me konceptet mësimore, duke i bërë fëmijët protagonist kryesor të inter-aksionit (ndërveprimit) me natyrën.

## VLERËSIMI NË ARSIM

Qëllimi i kursit është të njihen studentët me parimet kryesore të procesit të vlerësimit me fokus të theksuar në vlerësimin e brendshëm (vlerësimi në klasë) dhe vlerësimin e jashtëm si dhe bazën filozofike të procesit të vlerësimit. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm, kursi do të trajtojë shtjellimin e koncepteve si vlerësimi formativ (formues) dhe sumativ (përmbledhës), procesi dhe instrumentet e vlerësimit të besueshëm, transparent dhe që i shërben zhvillimit të nxënësve. Këto koncepte do të shtjellohen nga këndvështrimi teorik i literaturës por edhe nga këndvështrimi praktik i kontekstit të sistemit shkollor në Kosovë nën zhvillimet e kurrikulës së bazuar në kompetenca. Ndërsa, në lidhje me vlerësimin e jashtëm, kursi do të ndihmojë studentët të njihen me qëllimet, të mirat dhe dobësitë e organizimit të vlerësimeve të jashtme në nivel Kosove (testi i maturës; testi i arritshmërisë, testi në klasën e 5-të) dhe në nivel ndërkombëtar (PISA, TIMMS, PIRLS).

## LETËRSI KOMBËTARE

Lënda përfshinë gjithë prodhimtarinë letrare artistike të shkrimtarëve më përfaqësues të popullit tonë, krijimtari e cila përkufizohet me katër periudha të mëdha të zhvillimit dhe të formësimit të saj. Ajo shpreh specifikat dhe rëndësinë e saj në kontekstin letrar historik të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të veçantive të gjinive, llojeve e zhanreve letrare, si dhe lidhshmërinë e saj me zhvillimin e përgjithshëm kulturor dhe qytetërues shqiptar. Elemente këto parësore të krijimit të veçantive individuale të secilit mësimdhënës të Republikës së Kosovës.

## MËSIMDHËNIA E MATEMATIKËS II

Lënda Mësimdhënia e matematikës II shqyrtohen përgjithësimet, modelet dhe funksionet si bazë për zhvillimin e të menduarit kritik e krijues. Zhvillimi i të menduarit gjeometrik dhe koncepteve themelore gjeometrike duke konsideruar nivelet e Van Heiles, të nxënës për figurat dhe vetitë, konceptet fillestare për matjet dhe të nxënës për transformimet gjeometrike zënë një vend parësor në kurs. Në kurs, do të shqyrtohen edhe konceptet themelore për të dhënat dhe elementet statistikore dhe zhvillimi i koncepteve të probabilitetit. Të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë kursit, mbështeten në mësimdhënien e bazuar në hulumtime, mësimdhënien e bazuar në probleme/projekte dhe zgjidhjen e problemeve me qëllim të promovimit të edukimit për STEAM dhe zhvillimit të shkathtësive të shekullit të 21-të.

## SHKATHTËSITË PËR JETË

Studentët njihen me materialet e ndryshme në natyrë dhe mjedisin jetësor të fëmijëve. Mësohen dhe zhvillohen idetë kreative, dizajnet, modelimet me të gjitha llojet e materialeve përmes të cilave realizohen projekte me motive të ndryshme si: letra, druri, tekstilet, artikujtë ushqimor, argjila, gipsi, sapunet, plastelina, qiri, etj. Zhvillojnë edukatën e ndërmarrësisë në jetë dhe hartimin e nje biznesi plani.

## VËSHTIRËSITË NË TË NXËNË

Ky kurs ka të bëjë me njohuritë mbi nocionet themelore në fushën e vështirësive në të nxënë, llojet e vështirësive në të nxënë/modelet e klasifikimeve, definicionet dhe karakteristikat e vështirësive në të nxënë, vështirësitë në të nxënë si pasojë e prapambetjes intelektuale, spektrit të autizmit, çrregullimeve në të folur dhe gjuhë, dëmtimeve në të dëgjuar dhe të pamur, si dhe çrregullimeve në sjellje.

## EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës Kurrikulare si çështje

ndërkurrikulare që nga viti 2016. Studenti-mësimdhënës për edukatore në fëmijërinën e hershme me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socio-ekonomik si dhe rolin e edukimit të gjërnërave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.

#### EDUKIMI PËR STEAM

Ky kurs ofron njohuri dhe shkathtësi për mbështetjen e paraqitjes së STEM (Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës) në të gjithë mjediset shkollore. Kursi Edukimi për STEM ka një qasje ndërdisiplinore të nxënies ku konceptet rigorozë akademike shoqërohen me mësim të botës reale ku studentët aplikojnë shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë në kontekste që krijojnë lidhje midis shkollës, komunitetit, punës dhe ndërmarrjes globale. Mësimdhënësit e ardhshëm do të mësojnë të mbështesin zhvillimin e aftësive STEM përmes qasjeve aktive, të angazhuara dhe zbatimëse për secilën temë, duke u përputhur me kurrikulën dhe duke angazhuar praktikën më të mirë të mësimdhënies siç janë: mësimdhënia e bazuar në hulumtim, në projekte dhe në probleme. Një nga synimet kryesore të këtij kursi është zhvillimi dhe fuqizimi i mësimdhënësve të rinj për edukimit për STEM.

#### LOJËRAT MATEMATIKORE

Ky kurs ofrohet në formë të punëtorisë me qëllim të angazhimit të studentëve në zhvillimin e shkathtësive për mësimdhënie të matematikës përmes lojërave dhe aktiviteteve kreative. Studentët punojnë me manipulativë dhe teknologji për të eksploruar matematikën, zgjidhjen e problemeve, dhe për të mësuar mënyra të ndryshme se si të zhvillojnë tek fëmijët të kuptuarit e përmbajtjeve matematikore

#### FILOZOFI EDUKIMI

Gjatë kursit, ne do të ofrojmë mundësinë të punojmë së bashku me studentët për të identifikuar qëndrimet themelore filozofike mbi edukimin. Ky kurs identifikon qëndrime të ndryshme filozofike dhe të ndërgjegjësohemi për filozofinë tonë për të mësuar marrëdhëniet midis çështjeve kryesore filozofike si idealizmi, realizmi, pragmatizmi, ekzistencializmi, postmodernizmi. Reflektimet e këtyre filozofive arsimore do të diskutohen mbi teorinë e edukimit në ndërtimin e sistemit arsimor dhe qasjes së mësimdhënies që paraqet komponentë kyçe të këtij kursi.

#### PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV

Ky kurs ofron njohuri për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të mësimdhënësve të ardhshëm për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve të kurrikulës dhe mësimdhënies. Në kurs trajtohen temat: dokumentacioni shkollos pedagogjik, menaxhimi sjelljeve sfiduese si bullizmi, dhuna, zgjidhja e konfliktit,

kurrikulat lëndore/programet mësimore nga klasa e parë deri në të pestën, ndërlihdja e RNL me metodologjinë përkatëse të mësimdhënies, çështjet ndërkurrikulare dhe integrimi i tyre në kurrikulat lëndore, analiza e teksteve mësimore në kurrikulat lëndore, planifikimi i aktiviteteve mësimore që zhvillojnë të menduarit kritik dhe kreativ, planifikimi i aktiviteteve të punës me nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe me prirje të vecanta.

#### PUNIMI I DIPLOMËS

Tema e diplomës përfaqëson një projekt tipik kërkimor që studentëve u kërkohet ta përfundojnë si pjesë e studimeve të tyre universitare. Qëllimi i punimit të diplomës është t'u ofrojë studentëve një mundësi për të eksploruar në mënyrë të pavarur një temë specifike brenda fushës së tyre të studimit dhe të demonstrojnë të kuptuarit e tyre për lëndën. Kjo iu lejon studentët të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që kanë fituar gjatë studimeve të tyre universitare për një pyetje apo problem të veçantë kërkimor.

Temat e diplomës mbikëqyren nga një mentor i zgjedhur nga secili student që përfaqëson fushën specifike të arsimit që është në interes të studentëve. Punimet e diplomës përgatiten duke punuar në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor dhe në bazë të Manualit të Temave të Diplomës për diplomën BA.

Zakonisht studentët e harmonizojnë procesin e tyre kërkimor me praktikën e mësimdhënies e cila bëhet në semestrin e tyre të fundit, ndërkohë që ata ndjekin edhe kursin për kërkimin arsimor.

Mësuesi si studiues është një nga qëllimet kryesore të programit në përgjithësi dhe tezat e diplomës përfaqësojnë mundësinë për të treguar se si është zhvilluar kjo aftësi gjatë programit.